



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstva za Obrazovanje Nauku
i Tehnologiju - Ministry of Education, Science and Technology*

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Prishtinë, më 10 tetor 2016

Ref. Nr: 219/01 B

Ministri i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të dispozitave të neneve 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare nr 82, 21 tetor 2010), si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 8 dhe shtojcën 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe të Ministrive (Gazeta Zyrtare, Nr. 1, 18 prill 2011), dispozitave të nenit 6 të Udhëzimit Administrativ nr. 21/2016 për ndarjen e mjeteve buxhetore nga kategoria subvencione dhe transfere, merr këtë:


V E N D I M

- I. Emërohet Komisioni për shqyrtimin e aplikimeve për subvencione, i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në këtë përbërje:
 - 1.1. Ferit Idrizi, kryesues,
 - 1.2. Enver Mekolli, anëtar,
 - 1.3. Lulavere Behluli, anëtare,
 - 1.4. Kushtrim Kozmaqi, anëtar,
 - 1.5. Elhame Shabani, anëtare,
- II. Obligohet Komisioni i emëruar në pikën 1 të këtij vendimi, të propozojë kushtet dhe kriteret e konkursit për ndarjen e subvencioneve për personat fizik dhe juridik dhe më së voni me 17 tetor 2016 t'ia dërgoj Sekretarit të Përgjithshëm, për miratim dhe publikim në Web faqe të MASHT-it.
- III. Obligohet Komisioni i emëruar në pikën 1 të këtij vendimi, të shqyrtoj aplikacionet dhe dokumentet e aplikuesve për subvencione brenda afatit prej 7 (shtatë) ditësh pas mbylljes së konkursit për aplikim.
- IV. Komisioni i veçantë ka përgjegjësi për administrimin e procesit të konkursit, shqyrtimin e aplikacioneve, hartimin e raporteve (konstatimeve dhe rekomandimeve) të cilat nënshkruhen dhe i dërgohen autoritetit themelues të tij, vendosjes për formulën e shpërndarjes së subvencioneve në fusha sipas nenit 5 të

UA nr. 21/2016, si dhe shqyrtimin e ankesave brenda afatit prej 7 (shtatë) ditësh, pas shpalljes së rezultateve të përfituesve të bursave.

- V. Komisioni i veçantë ka përgjegjësi për sigurimin e punës transparente, objektive dhe vlerësimit profesional të aplikacioneve.
- VI. Obligohet Divizioni për Koordinim të Politikave dhe Statistika të krijoj bazën e të dhënave të kandidatëve që aplikojnë dhe projektet e tyre.
- VII. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i MASHT për zbatimin e këtij vendimi në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- VIII. Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

Prof. Dr. Arsim BAJRAMI, *Ministër*



Iu dërgohet:

- Të emëruarve sipas këtij vendimi;
- Sekretarit të Përgjithshëm të MASHT;
- Arkivit të MASHT.